



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimi të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Driton Fetaj	24.11.2025	04.12.2025	2025/1136

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.11.2025, OE "N.T.SH." BIZUN ""- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/1136, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë Grami SH.P.K., XHORXH BUSH NR.19, 10000, PRISHTINË, , lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Hidroksid Ntriumi" me nr. të prokurimit: "KEK-25-10367-1-2-5", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a..Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë, negociuar, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 117000 €

Lidhur me këtë lëndë NUK është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2025/1136 i dt:18.11.2025.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.SH." BIZUN "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Hidroksid Natriumi" me numër të prokurimit: "KEK-25-10367-1-2-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-25-10367-1-2-5**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me Hidroksid Natriumi**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	N.T.SH." BIZUN "
NUI	600360044
Adresa	Rr. Selami Pulaha A4 2/7
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Flatra Bajgora
Adresa elektronike	bizun.b@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	18.11.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.SH." BIZUN "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Hidroksid Natriumi" me numër të prokurimit: "KEK-25-10367-1-2-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me Hidroksid Natriumi

-Ftesa nga KEK-Bizun- Ftese.pdf.pdf13.11.2025 14:48

-Pyetje nga BIZUN-PyetjeNaOH_13.11.2025.pdf13.11.2025 15:15

-Pergjigje nga KEK-300-Pyetje-pergjigje.docx13.11.2025 15:46

-B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues

300 Njoftimi mbi vendimin e AK-se + LS.pdf14.11.2025 15:48

-Kërkesë për rishqyrtim - Kerkese per rishqyrtim_NaOH_3muaj17.11.2025 00:39

-Vendimi nga AK_KEKO-25-300-125 Pergjigjja e kerkeses per rishqyrtim.pdf17.11.2025 10:31

-B08 Njoftim për dhënie të kontratës 17.11.2025 10:36

Kodi i dokumentit: 2025/KEK-25-10367-1-2-5/B08-0027119

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

-Ftesa nga KEK-Bizun- Ftese.pdf.pdf13.11.2025 14:48

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.SH." BIZUN "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Hidroksid Natriumi" me numër të prokurimit: "KEK-25-10367-1-2-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

-Pyetje nga BIZUN-PyetjeNaOH_13.11.2025.pdf13.11.2025 15:15
-Pergjigje nga KEK-300-Pyetje-pergjigje.docx13.11.2025 15:46
-B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues
300 Njoftimi mbi vendimin e AK-se + LS.pdf14.11.2025 15:48
-Kërkesë për rishqyrtim - Kerkese per rishqyrtim_NaOH_3muaj17.11.2025 00:39
-Vendimi nga AK_KEKO-25-300-125 Pergjigjja e kerkeses per rishqyrtim.pdf17.11.2025 10:31
-B08 Njoftim për dhënie të kontratës 17.11.2025 10:36
Kodi i dokumentit: 2025/KEK-25-10367-1-2-5/B08-0027119

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne jemi ftuar për ofertim në procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, me titull Furnizim me Hidroksid Natriumi KEK-25-10367-1-2-5 me datën 13.11.2025, ora 14:48.
Afati për dorëzimin e ofertave ka qenë 14.11.2025, ora 12:00.

Kjo ftesë na erdhi pas kualifikimit tonë si kompani e përgjegjshme për furnizim trevjeçar me Hidroksid Natriumi, e cila procedurë është kontratëkornizë me minitender për produktin identik Furnizim me Hidroksi Natriumi.

*Sqarim për OSHP-në: KEK-u është në proces të zhvillimit të një procedure për Furnizim me Hidroksid Natriumi, e që kjo procedurë është kontratë kornizë 3 vjeçare me mini tender. Në këtë procedurë ne kemi aplikuar, me crast është bërë njoftimi mbi vendimin nga KEK me 11.11.2025, ku jemi të kualifikuar si kompani e përgjegjshme për të ofruar me mini tender në 3 vitet e ardhshme sa do të zgjat kjo kontratë. Ndërkohë, KEK për të njejtin produkt (identik), shpall procedurë ekstra emergjente, ku len afat vetëm 5 orë pune për të aplikuar dhe kërkon dokumentacion dhe vendos kritere më të larta se në procedurën 3 vjeçare.
P.S. Këtë sqarim e bëmë vetëm që ju si OSHP ta keni më të qartë se për çfarë jemi duke folur.*

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.SH." BIZUN "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Hidroksid Natriumi" me numër të prokurimit: "KEK-25-10367-1-2-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

Kualifikimi jonë në këtë procedurë është bërë duke e pas për bazë ofrimin e garancisë së prodhuesit tonë për furnizimin me Hidroksid Natriumi nga Nëntori 2025 për 3 vite sic është kërkuar në DT.

Që nga bartësi i kësaj lënde , komisioni i vlerësimit të ofertave, e deri tek udhëheqësi i prokurimit, e dijnë dhe kanë dokumentacion të mjaftueshëm se ne jemi të autorizuar për shitjen e Hidroksid Natriumit nga prodhuesi Borsodchem, dhe se prodhuesi na garanton furnizimin me Hidroksid Natriumi. Gjithashtu, edhe historia e kompanisë tonë tregon se kemi dhe jemi duke realizuar me sukses kontrata për furnizim të kemikaleve nga ky prodhues.

Të gjitha kërkesat e kësaj dosje të parapërgaditur për të ulur konkurrencën, kanë karakter administrativ që automatikisht bazuar në LPP kanë edhe karakter historik. Në asnjë mënyrë nuk ndikojnë në prishjen e kualitetit dhe sigurinë në furnizim emergjent të produktit të ofruar.

Arsyeja e eliminimit ka qenë kjo, *në DT është kërkuar: "1.3.Deklaratë e prodhuesit që e garanton Operatorin me furnizim të NaOH 45-50% sipas standardit EN 896:2012, ndërsa ju keni ofruar deklarate nga dileri i autorizuar po marrëveshja ndërmjet prodhuesit dhe dilerit është për një aktivitet të prokurimit tjetër (aktivitetin e prokurimit të kaluar)."*

Arsyeja e eliminimit nuk qëndron fare, sepse ne përveç marrëveshjes me prodhuesit dhe distributorin e cila është për të njëjtin produkt identik Hidroksid Natriumi, por një aktivitet tjetër të prokurimit , dhe e cila marrëveshje na mbështet për furnizim me Hidroksid Natriumi që nga Nëntori 2025 për 3 vite me radhë, ne kemi ofruar edhe një dokument nga prodhuesi i cili e mbështet distributorin tonë për furnizim me Hidroksid Natriumi për 1 vit.

Dokumenti mbanë datë 30.12.2024 dhe është valid nga 01.01.2025 deri me 31.12.2025. Kjo i bie se është para ftesës për ofertë në këtë rast, dhe se bazuar në këtë dokument, distributori na ka mbështetur me deklaratë se do të furnizojmë këtë sasi të Hidroksid Natriumit me të gjitha afatet emergjente të kërkuara nga KEK.

Në dosje të tenderit, nuk ka qenë e specifikuar forma (apo formati i dokumentit mbështetës), e që KEK në këtë rast nuk ka të drejtë të na eliminojë duke u thirrur vetëm në dokumentin mbështetës të cilin ne e kemi ofruar, i cili ka qenë edhe pjesë e dosjes së tenderit të kaluar, por që prap po e themi që është për të njëjtin produkt Hidroksid Natriumi, ndërkohë në arsyen e eliminimit nuk përmendet fare se ne kemi ofruar edhe një dokument shtesë nga prodhuesi i cili e mbështet distributorin tonë për furnizim një vjeçar 01.01.2025 deri me 31.12.2025 me po të njëjtin produkt Hidroksi Natriumi.

Kërkesa 1.3 për të cilën jemi eliminuar është ekzaktesisht kështu:

1.3. Deklaratë e prodhuesit që e garanton Operatorin me furnizim të NaOH, 45-50% sipas standardit EN 896:2012

Kjo kërkesë nuk është e vendosur tek : Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, por është vetëm tek specifikimet teknike të DT-se.

Sic shihet në këtë kërkesë, nuk ka të specifikuar format, nuk thuhet që marrëveshja duhet të përmbajë numër të prokurimit për lëndën specifike, nuk përmendet sasi as periudhë, por vetëm thuhet deklarata e prodhuesit

që e garanton operatorin me furnizim të NaOH(Hidroksid Natriumi).

Andaj, ne kemi ofruar dokumentin e lëshuar nga prodhuesi i cili e garanton distributorin tonë për furnizim me Hidroksid Natriumi për periudhën 1 vjeçare, gjithashtu distributori bazuar në këtë dokument na ka dhënë mbështetje me dokument specifik për këtë tender.

Kësaj lënde, ne do ti bashkëngjesisim, **marrvëshjen 3 vjeçare në mes të prodhuesit tonë dhe distributorit për furnizim me Hidroksid Natriumi**. Edhe pse kjo marrëveshje mban numër tjetër të prokurimit, është decitivisht dhe ekkzaktësisht për të njëjtin produkt, është valide nga Nënori 2025 deri në Tetor 2028, dhe ka për qëllim të liferohet në lëndën në të cilën jemi eliminuar.

Këtë dokument, e ofrojmë në menyrë që OSHP të bindet se ne jemi të autorizuar nga ky prodhues për ta shitur këtë produkt në periudhën 3 vjeçare. Gjithashtu në këtë DT ka qenë i ofruar dokumenti nga prodhuesi që e mbështet distributorin tonë për furnizim 1 vjeçar 01.01.2025 deri me 31.12.2025 me Hidroksid Natriumi.

KEK-ut nuk i mjaftuan këto dokumente për ta vendosur parasysh **Nenin 1 të LPP-se** që ka për qëllim mbrojtjen e parasë publike, por se me këtë vlerësim dhe eliminimin e kompanisë tone, e dëmtuan buxhetin në vlerë prej **35 750 EUR**.

Prodhuesi me të cilin kemi ofertuar ne, është Borsodchem nga Hungaria, i cili punon me të gjitha standardet evropiane duke qenë se rreth 80% të produktit të tij e shet në shtetet e BE-se. Këtë po e themi për ta bindur OSHP-në, se eliminimi jonë nuk ka të bëjë asgjë me kualitetin e mallit të ofruar apo mos sigurinë në liferim, por vetëm me trikat dhe tendencën e KEK-ut për të na eliminuar, për ta dëmtuar buxhetin në vlerën **35 750 EUR dhe për përfitimet e individeve të caktuar brenda KEK-ut**.

Andaj, duke pas parasysh faktet e lartëcekura, dokumentet që do t'ju ofrojmë për ta mbështetur gjithë këtë që e cekëm lartë, qëllimin e LPP-së që është mbrojtja e parasë publike, lusim OSHP-në që këtë lëndë ta kthejë në rivlerësim dhe të na ndihmojë edhe ne si kompani që ta ndalim një keqpërdorim të cilin po e bënë KEK pa as një bazë ligjore dhe me të vetmin qëllim përfitimin e individeve brenda KEK-ut.

9. Dëmet materiale

Përkrahja mënyrë se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

NA

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes se mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*

- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.SH." BIZUN "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Hidroksid Natriumi" me numër të prokurimit: "KEK-25-10367-1-2-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.

--

teknike të detyrueshme		kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.		
Variantet	4.1	Variante autorizohen: Po ☐ Jo ☒		
Kushtet dhe kërkesat e dërgesës	5.1	Vendi i dërgesës është: Depo e TCA		
	5.2	Kushtet e dërgesës: DDP pa TVSH		
	5.3	Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: Fillimi i realizimit të kontratës menjëherë pas nënshkrimit, përfundimi në afat prej 3 muajve nga nënshkrimi. Liferimi i një cisterne në TCA do të behet në afat prej 1 dite pas nënshkrimit, kurse sasia tjetër do të liferohet në afat prej 10 ditësh sipas fletëporosisë nga Menaxheret e Kontratës (planit dinamik).		
Kërkesat e përshtatshmërisë	6.4	Përveç deklaratës së shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2, dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkojnë nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet Dokumentet të cilat do të kërkojnë si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë janë me se vijon: a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. b. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (kontributi i sigurimit social), i dhe k] certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situatë e tillë nuk ekziston. c. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës] Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.		
		<table><tr><td>Kërkesat e përshtatshmërisë: 1.Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 Neni 65. 2.Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet</td><td>Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1.Një deklaratë nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë, pika 2, dhe 3 do të kërkojnë nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet</td></tr></table>	Kërkesat e përshtatshmërisë: 1.Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 Neni 65. 2.Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet	Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1.Një deklaratë nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë, pika 2, dhe 3 do të kërkojnë nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet
Kërkesat e përshtatshmërisë: 1.Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 Neni 65. 2.Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet	Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1.Një deklaratë nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë, pika 2, dhe 3 do të kërkojnë nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet			

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.SH." BIZUN "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Hidroksid Ntriumi" me numër të prokurimit: "KEK-25-10367-1-2-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

		vetëm për fituesin e tenderit. 3.Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmerisë" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – original ose kopje e noterizuar .- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit.	
Kërkesat e përshtatshmerisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmeria profesionale 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; 2.Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit 3.Regjistrimi i numrit fiskal	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1.Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend Kopja e certifikatës së biznesit); 2.Kopja e certifikatës TVSH-se; 3.Kopja e certifikatës numrit fiskal
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional 1. Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1a) Certifikata e prodhuesit sipas ISO 9001 2015, ISO 45001 dhe ISO 14001 1b) Certifikata e kualitetit të produktit sipas standartit për produktet e kërkuara
Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	a.një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës b.një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d.Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmerinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.	
Nënkontraktimet	12.1	a)një deklaratë ku deklarohen nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit, dhe b)Të gjithë nënkontraktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmerinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.	
Siguria e tenderit	13.1	Shëno një nga opsionet: Po ☒ Jo ☐ Nëse kërkohet sigurimi i tenderit:	

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.SH." BIZUN "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Hidroksid Natriumi" me numër të prokurimit: "KEK-25-10367-1-2-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtuar nga OE "N.T.SH." BIZUN "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Hidroksid Natriumi" me numër të prokurimit: "KEK-25-10367-1-2-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.



KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KOPORACIJA KOSOVA D.D.

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Furnizim me Hidroksid Natriumi; Numri i aktivitetit të prokurimit: KEK-25-10367-1-2-5/ KEKO-25-300-125

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës	Çmimi pas negociimit
1.	N.T.SH." BIZUN ", Rr. Selami Pulaha A4 2/7, 10000, PRISHTINË	92,250.00	74,250.00
2.	Grami SH.P.K., XHORXH BUSH NR.19, 10000, PRISHTINË	115,000.00	110,000.00
3.	BORA DENTAL SH.P.K., Rr.Bernice e Eperme, 10000, Prishtine	88,750.00	88,750.00

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a. shperblen me kontrate OE Grami SH.P.K. ne vlere prej 110,000.00€.

Emri dhe mbiemri i ZPP: Q. H. H. H.

Data: 19.11.2025

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.SH." BIZUN "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Hidroksid Natriumi" me numër të prokurimit: "KEK-25-10367-1-2-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.



Letër standarde për [tenderuesin] e eliminuar ¹

Nga:

KEK- Zyra Ekzekutive e Prokurimit,
Ndërtesa e Toskanes , Rr. Nënë Tereza, 36
1000 Prishtinë

Për: N.T.SH." BIZUN ", Rr. Selami Pulaha A4 2/7, 10000 PRISHTINË

Nr2 i prokurimit	KEK-25-10367-1-2-5
Nr i brendshëm	KEKO-25-300-125

Titulli: Furnizim me Hidroksid Natriumi

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:


ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këtë arsye :

Ne DT eshte kerkuar 1.3. Deklaratë e prodhuesit që e garanton Operatorin me furnizim të NaOH, 45-50% sipas standardit EN 896:2012., ndersa ju keni ofruar nje deklarate nga dileri i autorizuar por marreveshja ndermjet prodhuesit dhe dilerit eshte per nje aktivitet te prokurimit tjeter (aktivitetin e prokurimit te kaluar).

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,


Zyra Ekzekutive e Prokurimit

14. 11. 2025

¹ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qene te pa përgjegjshëm dhe të porregullt.

² Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.SH." BIZUN "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Hidroksid Natriumi" me numër të prokurimit: "KEK-25-10367-1-2-5", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

//

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

//

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

//

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

//

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - N.T.SH." BIZUN "

Sqarim hyrës Me datën: 18.11.2025, OE "N.T.SH." BIZUN ""- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/1136, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë Grami SH.P.K., XHORXH BUSH NR.19, 10000, PRISHTINË, , lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Hidroksid Natriumi" me nr. të prokurimit: "KEK-25-10367-1-2-5", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a..Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë, negociuar, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 117000 €

Pretendimi i O E "N.T.SH." BIZUN.

Ne jemi ftuar për ofertim në procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, me titull Furnizim me Hidroksid Natriumi KEK-25-10367-1-2-5 me datën 13.11.2025, ora 14:48. Afati për dorëzimin e ofertave ka qenë 14.11.2025 , ora 12.00. Kjo ftesë na erdhi pas kualifikimit tonë si kompani e përgjegjshme për furnizim trevjeçar me Hidroksid Natriumi, e cila procedurë është kontratëkornizë me minitender për produktin identic Furnizim me Hidroksi Natriumi.

Sqarim për OSHP-në: KEK-u është në proces të zhvillimit të një procedure për Furnizim me Hidroksid Natriumi, e qe kjo procedurë është kontratë kornizë 3 vjeçare me mini tender. Në këtë procedurë ne kemi aplikuar, me crast është bërë njoftimi mbi vendimin nga KEK me 11.11.2025, ku jemi të kualifikuar si kompani e përgjegjshme për te ofruar me mini tender në 3 vitet e ardhshme sa do të zgjat kjo kontratë. Ndërkohë, KEK për të njëjtin produkt (identik), shpall procedurë ekstra emergjente, ku len afat vetëm 5 orë pune për të aplikuar dhe kërkon dokumentacion dhe vendos kritere më të larta se në procedurën 3 vjeçare. P.S. Këtë sqarim e bëmë vetëm që ju si OSHP ta keni më të qartë se për

cfar jemi duke folur Kualifikimi jonë në këtë procedurë është bërë duke e pas për bazë ofrimin e garancisë së prodhuesit tonë për furnizimin me Hidroksid Natriumi nga Nëntori 2025 për 3 vite sic është kërkuar në DT.

Që nga bartësi i kësaj lënde , komisioni i vlerësimit të ofertave, e deri tek udhëheqësi i prokurimit, e dijnë dhe kanë dokumentacion të mjaftueshëm se ne jemi të autorizuar për shitjen e Hidroksid Natriumit nga prodhuesi Borsodchem, dhe se prodhuesi na garanton furnizimin me Hidroksid Natriumi. Gjithashtu, edhe historia e kompanisë tonë tregon se kemi dhe jemi duke realizuar me sukses kontrata për furnizim të kemikaleve nga ky prodhues.

Të gjitha kërkesat e kësaj dosje të parapërgaditur për të ulur konkurrencën, kanë karakter administrativ që automatikisht bazuar në LPP kanë edhe karakter historik. Në asnjë mënyrë nuk ndikojnë në prishjen e kualitetit dhe sigurinë në furnizim emergjent të produktit të ofruar.

Arsyeja e eliminimit ka qenë kjo, në DT është kërkuar: "1.3.Deklarate e prodhuesit që e garanton

Operatorin me furnizim të NaOH 45-50% sipas standardit EN 896:2012, ndërsa ju keni ofruar deklarate nga dileri i autorizuar po marrëveshja ndërmjet prodhuesit dhe dilerit është për një aktivitet të prokurimit tjetër (aktivitetin e prokurimit të kaluar)."

Arsyeja e eliminimit nuk qëndron fare, sepse ne përveç marrëveshjes me prodhuesit dhe distributorin e cila është për të njëjtin produkt identik Hidroksid Natriumi, por një aktivitet tjetër të prokurimit , dhe e cila marrëveshje na mbështet për furnizim me Hidroksid Natriumi që nga Nëntori 2025 për 3 vite me radhë, ne kemi ofruar edhe një dokument nga prodhuesi i cili e mbështet distributorin tonë për furnizim me Hidroksid Natriumi për 1 vit.

Dokumenti mbanë datë 30.12.2024 dhe është valid nga 01.01.2025 deri me 31.12.2025. Kjo i bie se është para ftesës për ofertë në këtë rast, dhe se bazuar në këtë dokument, distributori na ka mbështetur me deklaratë se do të furnizojmë këtë sasi të Hidroksid Natriumit me të gjitha afatet emergjente të kërkuara nga KEK. Në dosje të tenderit, nuk ka qenë e specifikuar forma (apo formati i dokumentit mbështetës), e që KEK në këtë rast nuk ka të drejtë të na eliminojë duke u thirrur vetëm në dokumentin mbështetës të cilin ne e kemi ofruar, i cili ka qenë edhe pjesë e dosjes së tenderit të kaluar, por që prap po e themi që është për të njëjtin produkt Hidroksid Natriumi, ndërsaq në arsyen e eliminimit nuk përmendet fare se ne kemi ofruar edhe një dokument shtesë nga prodhuesi i cili e mbështet distributorin tonë për furnizim një vjeçar 01.01.2025 deri me 31.12.2025 me po të njëjtin produkt Hidroksi Natriumi. Kërkesa 1.3 për të cilën jemi eliminuar është ekzaktësisht kështu:

1.3. Deklaratë e prodhuesit që e garanton Operatorin me furnizim të NaOH, 45-50% sipas standardit EN 896:2012 Kjo kërkesë nuk është e vendosur tek : Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, por është vetëm tek specifikimet teknike të DT-se.

Sic shihet në këtë kërkesë, nuk ka të specifikuar format, nuk thuhet që marrëveshja duhet të përmbajë numër të prokurimit për lëndën specifike, nuk përmendet sasi as periudhë, por vetëm thuhet deklarata e prodhuesit që e garanton operatorin me furnizim të NaOH(Hidroksid Natriumi).

Andaj, ne kemi ofruar dokumentin e lëshuar nga prodhuesi i cili e garanton distributorin tonë për furnizim me Hidroksid Natriumi për periudhën 1 vjeçare, gjithashtu distributori bazuar në këtë dokument na ka dhënë mbështetje me dokument specifik për këtë tender.

Kësaj lënde, ne do ti bashkëngjeshim, marrëveshjen 3 vjeçare në mes të prodhuesit tonë dhe distributorit për furnizim me Hidroksid Natriumi. Edhe pse kjo marrëveshje mban numër tjetër të prokurimit, është

decizivisht dhe ekzaktësisht për të njëjtin produkt, është valide nga Nëntori 2025 deri në Tetor 2028, dhe ka për qëllim të liferohet në lëndën në të cilën jemi eliminuar.

Këtë dokument, e ofrojmë në menyrë që OSHP të bindet se ne jemi të autorizuar nga ky prodhues për ta shitur këtë produkt në periudhën 3 vjecare. Gjithashtu në këtë DT ka qenë i ofruar dokumenti nga prodhuesi që e mbështet distributerin tonë për furnizim 1 vjecar 01.01.2025 deri me 31.12.2025 me Hidroksid Natriumi.

KEK-ut nuk i mjaftuan këto dokumente për ta vendosur parasysh Nenin 1 të LPP-se që ka për qëllim

mbrojtjen e parasë publike, por se me këtë vlerësim dhe eliminimin e kompanisë tone, e dëmtuan buxhetin në vlerë prej 35 750 EUR.

Prodhuesi me të cilin kemi ofertuar ne, është Borsodechem nga Hungaria, i cili punon me të gjitha standardet evropiane duke qenë se rreth 80% të produktit të tij e shet në shtetet e BE-se. Këtë po e themi për ta bindur OSHP-në, se eliminimi jonë nuk ka të bëjë asgjë me kualitetin e mallit të ofruar apo mos sigurinë në liferim, por vetëm me trikat dhe tendencën e KEK-ut për të na eliminuar, për ta demtuar buxhetin në vlerën 35 750 EUR dhe për përfitimet e individëve të caktuar brenda KEK-ut.

Andaj, duke pas parasysh faktet e lartëcekura, dokumentet që do tju ofrojmë për ta mbështetur gjithë këtë që e cekëm lartë, qëllimin e LPP-së që është mbrojtja e parasë publike, lusim OSHP-në që këtë lëndë ta kthejë në rivlerësim dhe të na ndihmojë edhe ne si kompani që ta ndalim një keqpërdorim të cilin po e bënë KEK pa as një bazë ligjore dhe me të vetmin qëllim përfitimin e individëve brenda KEK-ut.

Përgjigje në Pretendimin OE "N.T.SH." BIZUN ""

Eksperti shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, lidhur me kërkesën e Autoritetit Kontraktues në Dosje Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet . Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1a) Certifikata e prodhuesit sipas ISO 9001 2015, ISO 45001 dhe ISO 14001 1b) Certifikata e kualitetit të produktit sipas standarit për produktet e kërkuara

Eksperti shqyrtues thekson se Hartimi i e dosjes të tenderit është kërkesës e nenit 27 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. dhe nenit 17 RRPP Ne përputhje me nenin 17 .12 të RRPP së 17.12 Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata shtaruese shtesë DHE NE dosje të tenderit është kërkuar 1a) Certifikata e prodhuesit sipas ISO 9001 2015, ISO 45001 dhe ISO 14001

- 1b) Certifikata e kualitetit të produktit sipas standarit për produktet e kërkuara

Mendim i Ekspertit mbi Pretendimet e Operatorit Ekonomik "N.T.SH." BIZUN për Afati i dorëzimit të ofertave ku OE pretendon se afati i 5 orëve për dorëzim është i papërmbyshshëm. Duke u bazuar në këtë, si ekspert konstatoj se afati i shkurtër i dhënë është kërkesë që është dashtë të trajtohet para hapjes së tenderit , e që për procedura emergjente Eksperti thekson se LPP nuk ka nen të veçantë për AFATE për "procedura emergjente". AK ka diskrecion në të , por afati duhet të jetë real dhe proporcional . Në këtë rast, pretendimi duhet të bëhet para afatit të Hapjes të ofertave .

Prandaj, eksperti Shqyrtues konstaton: Pretendimi mbi afatin është i pabazuar në këtë fazë.

Ndërsa Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet . Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1a) Certifikata e prodhuesit sipas ISO 9001 2015, ISO 45001 dhe ISO 14001

1b) Certifikata e kualitetit të produktit sipas standarit për produktet e kërkuara

Eksperti Shqyrtues thekson se Sipas RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve paragrafi

40.2 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosje të tenderit dhe kontrata do të jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve..... dhe se 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

40.12 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë

të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në dosjen e tenderit.

Dhe 2. Kapaciteti teknik / profesional Në DT është kërkuar: 1a) Certifikata ISO 9001, ISO 14001, ISO 45001 1b) Certifikata e kualitetit sipas standardit EN O.E i ka dorëzuar dokumentet e kërkuara. Nuk ka pretendim mbi to.

Eksperti shqyrtues thekson se Kërkesa 1.3 nga specifikimet teknike 1.3. Deklaratë e prodhuesit që e garanton Operatorin me furnizim të NaOH, 45-50% sipas standardit EN 896:2012.

Kjo kërkesë NUK është e vendosur te "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale", por vetëm te specifikimet teknike.

Eksperti shqyrtues thekson se Specifikimet teknike, sipas LPP, kanë qëllim të përshkruajnë produktin – jo të kufizojnë konkurrencën. Në kërkesë: nuk është kërkuar format, nuk është kërkuar numër tenderi, nuk është kërkuar periudhë, nuk është kërkuar që deklarata të jetë vetëm për këtë procedurë, nuk është kërkuar marrëveshje direkte prodhues–OE, nuk është ndaluar përdorimi i deklaratave mbështetëse për periudhat ekzistuese. Por është kërkuar 1.3. Deklaratë e prodhuesit që e garanton Operatorin me furnizim të NaOH, 45-50% sipas standardit EN 896:2012 Operatori Ekonomik ka ofruar: Dokument nga prodhuesi 01.01.2025–31.12.2025. Deklaratë mbështetëse specifike për tenderin. Marrëveshje prodhues–distributor 3-vjeçare për të njëjtin produkt. Dhe sipas nenit 40.12 të Rregullores: Tenderuesi nuk do të përjashtohet për kërkesa që nuk janë specifikuar në DT.

Autoritet Kontraktues e ka përjashtuar OE për një kriter që nuk është i shënuar në DT (p.sh. lidhja me numër tenderi ose lënde). Në kontekst të kësaj qeshje

Eksperti Shqyrtues Thekson se edhe Autoriteti Kontraktues ka mundur të veproi edhe sipas Dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lagjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1.Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose

duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës..

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Eksperti shqyrtues në përfundim të kësaj Ekspertize thekson se ;Pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit të lëndës, pretendimeve të operatorit ekonomik ankues dhe veprimeve të Autoritetit Kontraktues, si dhe duke u mbështetur në Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 01/2022, thekson sa vijon:

Autoriteti Kontraktues ka aplikuar gabimisht kriter të pa-parashikuar në Dosjen e Tenderit, duke kërkuar elemente të deklaratës së prodhuesit që nuk figurojnë në Kërkesat mbi mundësitë teknike/profesionale, në kundërshtim me nenin 40.2 dhe 40.12 të Rregullores së Prokurimit Publik.

OE ka dorëzuar dokumentet e kërkuara në DT, përfshirë certifikatat ISO dhe deklaratën e prodhuesit, e cila juridikisht i plotëson kërkesat e specifikimeve teknike, pasi DT nuk ka vendosur kufizime shtesë mbi formën apo përmbajtjen e dokumentit. AK nuk ka përdorur mekanizmin ligjor të nenit 72 të LPP-së, i cili i mundëson autoritetit kërkimin e sqarimeve apo kompletimin e dokumenteve para marrjes së vendimit për përjashtim. Si rezultat i këtyre mangësive procedurale dhe aplikimit të kriterëve të pa-parashikuar, përjashtimi i OE-së nuk është bërë në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës të parashikuara në LPP.

Në bazë të të gjitha sa më sipër, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik është i BAZUAR.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa kontrata e nënshkruar nga AK të shfuqizohet.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtuar nga OE "N.T.SH." BIZUN "", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Hidroksid Natriumi" me numër të prokurimit: "KEK-25-10367-1-2-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – N.T.SH." BIZUN "

